



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, përkatësisht më 22 dhe 24 maj, Trupi Gjykses lëshoi vendime mbi kërkesat e Prokurorisë për praninë në prova të deklaratave të dëshmitarëve dhe provave materiale shoqëruese në formë të shkruar. Megjithatë dëshmitarët do të paraqiten në sallë të gjyqit për t'u marrë në pyetje nëse është e nevojshme, kjo do të shkurtojë shumë kohëzgjatjen e marrjes në pyetje.

Vendimi i datës 22 maj, ka të bëjë me deklaratat dhe provat materiale shoqëruese të shtatë dëshmitarëve. Trupi Gjykses miratoi këtë kërkesë lidhur me pesë deklarata të dëshmitarëve në tërësi, ndërsa për dy deklarata të tjera pjesërisht, duke konstatuar se disa prova materiale nuk ishin të përshtatshme për praninë në prova.

Në lidhje me vendimin e 24 majit, Trupi Gjykses miratoi një kërkesë të Prokurorisë për të tre dëshmitarët dhe konstatoi se provat materiale shoqëruese ishin të përshtatshme për praninë në prova pasi autenticiteti i tyre të konfirmohet nga dëshmitarët në sallë të gjyqit.

Që nga përditësimi i javës së kaluar, në këtë çështje kanë dhënë dëshmi 4 dëshmitarë. Një dëshmitar dëshmoi me masa mbrojtëse dhe kryesisht në seancë private dhe një tjetër nëpërmjet videolidhjes. Sipas përmbledhjes që paraqiti ZPS-ja në sallë të gjyqit, dëshmitari i dytë është shqiptar nga Kosova, i cili u mbajt i ndaluar dhe u keqtrajtua nga anëtarë të UÇK-së në pranverë dhe verë të 1998-ës.

Të martën paradite, filloi dhënien e dëshmisë Jan Kikert (Kickert). Z. Kikert është diplomat austriak, i cili sipas përmbledhjes së ZPS-së ishte në Beograd gjatë periudhës përkatëse dhe pati kontakte me udhëheqësit e UÇK-së për t'i përfshirë ata në procesin politik. Në 1999, ai ishte këshilltar politik i UNMIK-ut. Dëshmitari i katërt, për të cilin u miratuan masa mbrojtëse, përfundoi dëshminë sot. Dëshmia u dha kryesisht në seancë private. Sipas përmbledhjes së paraqitur nga ZPS-ja, dëshmitari u mbajt i ndaluar dhe keqtrajtua nga UÇK-ja dhe u arratis nga vendi ku mbahej i ndaluar.

Të hënën pasdite u mbajt një konferencë mbi ecurinë e çështjes gjatë së cilës palët diskutuan mënyrën e zhvillimit sa më të shpejtë të gjykimit dhe thjeshtimin e dhënies së dëshmive nga dëshmitarët e ardhshëm.

Pas konferencës mbi ecurinë e çështjes, të mërkurën më 29 maj, Trupi Gjykses urdhëroi Prokurorinë që të njoftojë se si do të thjeshtojë më tej paraqitjen e provave të saj më së voni deri më 16 shtator 2024. Pas kësaj, Trupi Gjykses do të mbajë konferencë për ecurinë e çështjes për të dëgjuar parashtrimet e palëve në lidhje me të. Gjithashtu, Trupi Gjykses e urdhëroi Prokurorinë të dorëzojë deri më 21 qershor planin se si synon të përfundojë paraqitjen e provave të saj deri më 1 prill 2025. Ky plan do t'i paraqitet vetëm Trupit Gjykses dhe në të duhet të përfshihen informacione si lista e dëshmitarëve, rendi në të cilin do të thirren,

1





dhe sa kohë parashikohet për marrjen në pyetje të secilit dëshmitar. Trupi Gjykues urdhëroi Mbrojtjen që të japë vlerësime realiste për kohën që parashikon se i duhet për marrjen në pyetje të çdo dëshmitari brenda tri ditësh pune pasi është njoftuar për grupin vijues të dëshmitarëve. Trupi Gjykues do t'i shqyrtojë ato dhe, kur është e nevojshme, do të caktojë kufij kohorë për kohëzgjatjen e marrjes në pyetje nga Mbrojtja.

Seancat në këtë çështje përfunduan për këtë javë dhe do të rifillojnë të hënën, më 3 qershor, në orën 9 të mëngjesit.

Më 23 maj, u bë publik një vendim i datës 7 maj në çështjen gjyqësore Pjetër Shala. Ky vendim ka të bëjë me Kërkesën e Mbrojtjes për Rishikim Gjyqësor të Vendimit të Administratores në lidhje me vizitat familjare dhe komunikimet me videolidhje. Trupi Gjykues e hodhi poshtë kërkesën.

Kërkesa e Mbrojtjes bazohet në një njoftim të lëshuar nga shefi i paraburgimit më 26 janar, që njoftonte se, duke filluar nga shkurti 2024, secilit të akuzuar do t'i caktohej një periudhë dhjetëditore çdo muaj për planifikimin e vizitave personale dhe përmes videolidhjes. Sistemi i ri u miratua për të garantuar ruajtjen e rregullit dhe sigurisë në objektin e paraburgimit, si dhe administrimin e burimeve.

Z. Shala u ankua se sistemi i ri kufizonte padrejtësisht të drejtën e tij për vizita. Pas ankesës dhe kërkesës për rishikim, Administratorja e shqyrtoi dhe përfundimisht konfirmoi vendimin e shefit të paraburgimit. Më pas, z. Shala kërkoi rishikim gjyqësor nga Trupi Gjykues të vendimit të Administratores.

Trupi Gjykues arriti në përfundimin se në vendimin e saj, Administratorja i balancoi si duhet të drejtat e të akuzuarit kundrejt kushteve në objektin e paraburgimit dhe të drejtave të të akuzuarve të tjerë, dhe gjithashtu mori parasysh nevojën për të siguruar që të gjithë të paraburgosurit kenë qasje të drejtë dhe të mjaftueshme në mjedise dhe pajisje për mbajtjen e marrëdhënieve personale. Trupi Gjykues vuri në dukje se gjatë atyre ditëve që z. Shala nuk ka vizita personale ose përmes videolidhjes, ai mund të komunikojë me familjen e tij dhe persona të tjerë me telefon.

Më 28 maj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Ismet Bahtijari. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se vazhdon të ekzistojë rrezik i moderuar se z. Bahtijari mund të arratiset, për shkak se data për t'ia kaluar çështjen gjyqësore trupit gjykues është caktuar për 21 qershor të këtij viti.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi gjithashtu se vazhdon të ekzistojë rreziku se z. Bahtijari do të pengojë ecurinë e procedurave penale dhe të kryejë vepra penale të tjera. Në lidhje me këtë, Gjykatësi mbajti parasysh veçanërisht faktin se i akuzuari ka mjete dhe mundësi të kontaktojë dëshmitarin 1, dhe ka gjasa të ketë qasje në rrjetet që kanë lidhje me të bashkakuzuarin e tij z. Shala dhe udhëheqës të tjerë të lartë të UÇK-së. Rrjedhimisht, nëse lirohet, z. Bahtijari ka motivin, mjetet dhe mundësitë për të ushtruar trysni ndaj dëshmitarit 1 që ta shkurajojë atë nga pjesëmarrja në proces gjyqësor. Sipas mendimit të Gjykatësit, masat





në fuqi në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ofrojnë garanci të forta për të zvogëluar rrezikun e këtyre rreziqeve.

### **Pyetje nga gazetarët**

Nuk pati pyetje

